



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
ODREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE GJIROKASTËR

STATUTI

I

DREJTORISË RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE
GJIROKASTËR

Viti 2019

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Objekti**

Ky Statut ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave të organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë veprimtaritë e sektorëve përbërës, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e DRTK.

Neni 2 **Baza ligjore**

Ky Statut bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", si edhe në aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, VKM nr. 531, datë 28.8.2019 "Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore", Urdhrin e Kryeministrit nr. 139, datë 21.10.2019 'për miratimin e strukturës dhe të organikës të Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore'.

Neni 3 **Statusi juridik**

- a) DRTK Gjirokastrë është person juridik publik, i njohur me ligj si i tillë.
- b) DRTK Gjirokastrë është institucion rajonal i specializuar, tekniko-administrative, buxhetore, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore
- c) DRTK Gjirokastrë organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, si edhe me rregullat e parashikuara në këtë Statut dhe në rregulloret e brendshme të funksionimit të tij.

Neni 4 **Misioni**

DRTK Gjirokastrë është institucion rajonal i specializuar tekniko-administrativ buxhetor që ushtron veprimtarinë e tij në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territoret si më poshtë:

- a) Në Qendrën Historike Gjirokastrë, pjese e listës se trashëgimisë botërore të UNESCO-s,
- b) Në Bashkinë Gjirokastrë;
- c) Në Bashkinë Libohovë;
- d) Në Bashkinë Tepelenë;

- e) Në Bashkinë Memaliaj;
- f) Në bashkinë Përmet;
- g) Në Bashkinë Këlcyrë;
- h) Në Bashkinë Dropull.

Neni 5

Parimet

Parimet nga të cilat udhëhiqet DRTK Gjirokastrë janë:

- a) Liria e informimit dhe informacionit
- b) Transparenca
- c) Meritokracia
- d) Mos diskriminimi

Neni 6

Zhvillimi i veprimtarisë

- a) Veprimtaria e DRTK-së Gjirokastrë organizohet dhe realizohet përmes sektorëve të saj përbërës.
- b) Në veprimtarinë dhe ushtrimin e funksioneve DRTK Gjirokastrë, monitorohet dhe koordinohet nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
- c) DRTK Gjirokastrë zhvillon veprimtarinë e saj brenda sistemit të trashëgimisë kulturore kombëtare si dhe në kuadër të marrëdhënieve me partnerë, institucione dhe organizma ndërkombëtar.
- d) DRTK Gjirokastrë anëtarësohet në organizma të përhershme, si dhe aktivizohet në organizma dhe veprimtari të përkohshme në fushën përkatëse, brenda ose jashtë vendit.
- e) DRTK Gjirokastrë në përputhje me misionin e vet, harton programe e projekte të veçanta, sipas nevojave dhe prioriteteve.
- f) DRTK Gjirokastrë është institucion laik dhe i depolitizuar.
- g) DRTK Gjirokastrë, si person juridik, merr pjesë në veprimtari të publike e private, brenda ose jashtë vendit, në ushtrim të funksioneve dhe në realizim të qëllimeve të saj të ligjshme.

Neni 7

Selitë

Selia qendrore e DRTK Gjirokastrë është në Rrugën Dr. Vasil Laboviti, nr 3 në lagjen “Varosh”, Gjirokastrë, ndërsa sektorët e tjerë të DRTK Gjirokastrë kanë selitë e tyre.

Neni 8

Simbolet dhe vula e DRTK Gjirokastrë

- a) Simbolet e DRTK Gjirokastër përfshijnë logon e DRTK Gjirokastër dhe logon e qendrës pasuri botërore. Formatit dhe elementët e logove janë paraqitur në lidhjen 1 të këtij Statuti.
- b) DRTK Gjirokastër ka vulën e saj në formë rrethore, ku përcaktohet emërtesa ligjore e institucionit me përmbajtje: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër”
- c) Në komunikimin zyrtar shkresor të vendoset stema e Republikës dhe emërtesa si vijon: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër”.

KREU II

ORGANIZIMI, STRUKTURAT PËRBËRËSE, FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT

Neni 9

Struktura dhe organika

Struktura dhe organika e DRTK Gjirokastër përbëhet nga:

- a) Drejtori (Titullari i institucionit)
- b) Sektorët
- c) Sektori i Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër
- d) Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Gjirokastër
- e) Sektori i Përmetit
- f) Sektori i Tepelenës
- g) Sektori i Menaxhimit të Qendrës Historike-Qendër e Trashëgimisë Botërore (UNESCO) Gjirokastër.
- h) Sektori i Menaxhimit të Parqeve Arkeologjike (Antigone Adreanopolis) Gjirokastër
- i) Drejtimi dhe organizmi i veprimtarisë së DRTK Gjirokastër realizohet në rend zbritës hierarkik drejtor, përgjegjës sektori, specialistë dhe personel mbështetës.
- j) DRTK Gjirokastër ka të drejtë të formojë komisione dhe/apo grupe pune, të cilët e ndihmojnë në kryerjen e misionit të vet.

Neni 10

Funksionet e Drejtorit

- a) Drejtori i DRTK Gjirokastër emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga Ministri i Kulturës, sipas procedurave të përcaktuara në VKM nr. 173, datë 7.03.2003 “Për

emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit.

- b) Drejtor emërohet personi që ka arsim të lartë në një fushë të përshtatshme me funksionin si Drejtor i DRTK-së Gjirokastër dhe për ushtrimin e kompetencave të DRTK-së, Gjirokastër. Drejtori i DRTK-së, Gjirokastër duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në VKM nr. 581, datë 28.08.2019 dhe kriteret e veçanta si më poshtë vijon:
 - c) Drejtori i DRTK Gjirokastër kryen këto funksione:
 - i. planifikon, drejton dhe koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit
 - ii. harton në bashkëpunim me sektorët dhe zbaton objektivat dhe planin e punës të DRTK-së Gjirokastër, në përputhje me misionin e saj dhe me politikën, strategjinë dhe objektivat e Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.
 - iii. Drejton veprimtarinë dhe praktikën administrative të institucionit dhe përfaqëson DRTK Gjirokastër në marrëdhënie me të tretët.
 - iv. Mbikëqyr dhe menaxhon efektivitetin e sektorëve dhe burimeve njerëzore.
 - v. Bashkërendon proceset e punës të sektorëve dhe orienton veprimtaritë kualifikuese me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale të personelit të DRTK Gjirokastër.
 - vi. Emëron dhe shkarkon punonjësit e institucionit në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar.
 - vii. nënshkruan marrëveshje me institucione dhe organizata vendase dhe të huaja pas miratimit në parim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore që synojnë bashkëpunim të ndërsjellët, projektet dhe aktivitete të përbashkëta si dhe shkëmbime dhe kualifikime të personelit.

Neni 11

Funksionet e Sektorëve

- a) DRTK Gjirokastër është organizuar në Sektorë si më poshtë vijon:
 - i. Sektori i Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore
 - ii. Sektori i Financës dhe shërbimeve Mbështetëse
 - iii. Sektori Përmet
 - iv. Sektori Tepelenë
 - v. Sektori i Menaxhimit të Qendrës Historike-Qendër e Trashëgimisë Botërore (UNESCO).
 - vi. Sektori i Menaxhimit të Parqeve Arkeologjike (Antigone Adreanopolis)

- b) Sektorët drejtohen nga përgjegjësit e Sektorëve të cilët kryejnë këto funksione:
 - i. Janë përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së sektorit dhe përmbushjen e detyrave të tij.
 - ii. planifikojnë, mbikëqyrin dhe koordinojnë veprimtaritë në sektor, në përputhje me planifikimin vjetor

- iii. propozojnë në bashkëpunim me sektorin dhe zbatojnë objektivat dhe planin e punës të sektorit-së në përputhje me misionin e DRTK dhe me politikën, strategjinë dhe objektivat e Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore
- iv. mbikëqyrin dhe menaxhojnë efektivitetin e sektorit
- v. bashkërendojnë proceset e punës brenda sektorit dhe orientojnë veprimtaritë kualifikuese me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale në përputhje me nevojat e sektorit.

c) Sektorët janë përgjegjës dhe kryejnë këto funksione:

D) Sektori i Sektorit i Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore është përgjegjës për ruajtjen, mirëmbajtjen, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale

i) në Bashkinë Gjirokastrë,

j) Në Bashkinë Libohovë;

k) Në Bashkinë Dropull.

II) Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjës për menaxhimin e financave dhe burimeve njerëzore dhe garantimin e zbatimit të kuadrit ligjor për të gjithë procedurat e lidhura me veprimtarinë e DRTK Gjirokastrë.

III) Sektori i Përmetit është përgjegjës për ruajtjen, mirëmbajtjen, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale në Bashkitë; Përmet dhe Këlcyrë.

IV) Sektori i Tepelenës është përgjegjës për ruajtjen, mirëmbajtjen, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale në Bashkitë; Tepelenë dhe Memaliaj

V) Sektori i Menaxhimit të Qendrës Historike-Qendër e Trashëgimisë Botërore (UNESCO), është Përgjegjës për menaxhimin e qendrës historike duke mbajtur kontakte të ngushta me organet e administratës qendrore, me organet e qeverisjes vendore, persona fizikë e juridikë, për restaurimin, evidentimin, mbrojtjen, gjurmimin, konservimin, studimin në monumentet e kulturës.

VI) Sektori i Menaxhimit të Parqeve Arkeologjike (Antigone Adreanopolis)

Është përgjegjës për mbrojtjen administrimin dhe mirëmbajtjen e Parkut Antigone Adreanopolis, për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe asaj natyrore, sipas dispozitave ligjore në fuqi

Neni 12

Kompetencat e DRTK Gjirokastrë

DRTK Gjirokastrë ka këto kompetenca:

- a) zbaton konventat ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

- b) gjurmon dhe përgatis vlerësime paraprake e gjithëpërfshirëse për deklarimin e interesit kulturor dhe dhënien e statusit të mbrojtjes;
- c) kryen verifikime sistematike për gjendjen e pasurive kulturore në territorin që administrojnë, si dhe në bazë të kërkesave të paraqitura;
- d) kryen verifikime dhe marrin masa, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në raste të situatave emergjente, kur rrezikohet gjendja e pasurive kulturore;
- e) harton projekte konservimi, restaurimi, vlerësimi, projekte të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore dhe bashkërendojnë punën për zbatimin e tyre në nivel rajonal e vendor;
- f) kryen punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore në bazë të projekteve të miratuara;
- g) kryen mbikëqyrjen dhe kolaudimin e zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale;
- h) Monitoron e administron Qendrën Historike Gjirokastrë dhe sigurojnë ruajtjen e vlerës së veçantë universale të saj
- i) Harton Raporte periodike për gjendjen e konservimit të pasurisë botërore në zbatim të vendimeve të komitetit të Trashëgimisë Botërore.
- j) kryen çdo funksion tjetër të parashikuar me ligj.

Neni 12 Punësimi

Punësimi i punonjësve të DRTK Gjirokastrë realizohet bazuar dhe në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjetë kontratave individuale të punës.

Rregullimi i marrëdhënieve të punës për sa i përket vlerësimit të performancës, përshkrimit individual të punës, klasifikimit të shkëlqeve, masave disiplinore dhe procedurat e zgjidhjes së kontratës së punës, përcaktohen në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të DRTK Gjirokastrë si dhe në kontratën e punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV ADMINISTRIMI FINANCIAR

Neni 13 Të ardhurat buxhetore

DRTK Gjirokastrë është institucion buxhetor shtetëror në varësi të Ministrisë së Kulturës

Fondi për buxhetin e DRTK Gjirokastër miratohet nga Ministri i Kulturës, pas miratimit në Kuvendin e Shqipërisë të ligjit për buxhetin vjetor.

Të ardhurat buxhetore krijohen dhe administrohen nga DRTK Gjirokastër sipas legjislacionit në fuqi: Vendimit nr. 432, dt. 28.06.2006 *“Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”* si dhe Udhëzimeve të Ministrit të Kulturës dhe Ministrit të Financës.

DRTK Gjirokastër, në kuadër të realizimit të projekteve për trashëgiminë kulturore, mund të marrë donacione dhe sponsorizime të ndryshme nga subjekte private ose organizata të ligjshme, shqiptare apo të huaja, në respektim të kuadrit ligjor në fuqi.

Fondet vjetore të akorduara nga buxheti i shtetit si dhe çdo e ardhur e realizuar nga sponsorizimet, donacionet etj., do të nënshtrohen procedurës së prokurimit publik.

Neni 14 **Hartimi i projekt buxhetit**

DRTK Gjirokastër, në tre mujorin e parë të çdo viti kalendarik, paraqet pranë Ministrisë së Kulturës, projekt buxhetin afatmesëm të shpenzimeve dhe të investimeve për vitin pasardhës, të shoqeruar me preventivat përkatës.

Neni 15 **Auditimi financiar**

Administrimi dhe veprimtaria financiare e DRTK Gjirokastër, auditohen nga Ministria e Kulturës si dhe institucione të tjera të ngarkuara me ligj për auditim.

KREU V **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Neni 16 **Ndryshimet në statut**

Ky statut përmirësohet sa herë që praktika e punës dhe ndryshimet në legjislacion e bëjnë të nevojshme një gjë të tillë. Ndryshimet në statut propozohen nga Drejtori i DRTK Gjirokastër dhe miratimi i ndryshimeve bëhet nga Ministri i Kulturës.

Neni 17 **Hyrja në fuqi**

Ky statut hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Ministri i Kulturës.